



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 615/10 prot.

Datë 25.04.2024

**V E N D I M**

**Nr. 417/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.04.2024 , mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 336/2024, datë 04.04.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-97735-03-07-2024 me objekt: “Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë, me fond limit 1,499,600.66 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21-03-2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK me NIPT K21605003M dhe adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës, Km.09, Kashar, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A..  
Adresa : *Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa”, Elbasan*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 04.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.336/2024, ku vendosi:  
[...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranar, për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-97735-03-07-2024 me objekt: “Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,499,600.66 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21-03-2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK’
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 889/1 prot., datë 15.04.2024, protokolluar me tonën nr. 615/7 prot., datë 19.04.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 336/2024 datë 04.04.2024 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-97735-03-07-2024 me objekt: “Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,499,600.66 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21-03-2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.

### II

#### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 889/1 prot., datë 15.04.2024, protokolluar me tonën nr. 615/7 prot., datë 19.04.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 336/2024 datë 04.04.2024 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-

97735-03-07-2024 me objekt: “Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 1,499,600.66 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21-03-2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe nga shqyrtimi në SPE, Komisioni Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor ka ngaruar shtojcën më datë 15.04.2024.

KPP konstaton se autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 336/2024 datë 04.04.2024.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-97735-03-07-2024 me objekt: “Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë, me fond limit 1,499,600.66 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21-03-2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

